SEKRETARIA
Date 16.03.2021
Nr. 545 Prot. 4406

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**
**PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI**

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 3285 Prot.
D. 19.03.2021

URDHËR

*"për vënien e sekuestros konservative"*

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Për dijeni: Ujesjellesi Has me NIPT J66702907H
Per dijeni: Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a me NIPT L81530016 IL

Pranë Zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me palë:

Debitori: Pompa Ujësjellësit Has, Ujesjellesi Has me NIPT J66702907H
Kreditori: Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a me NIPT L81530016 IL
Objekti: Përmbushje Detyrimi

Unë Përmbaruesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarimore:

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Fatura Tatimore te konsumit te Energjise elektrike referuar Kontratës së furnizimit Nr. KU0H150107115913 për periudhen Dhjetor 2014- Shtator 2018, është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr.(1253)369, datë 13.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës me objekt:

*"Lëshimin Urdhrit të Ekzekutimit për Fatura Tatimore te konsumit te Energjise elektrike referuar Kontratës së furnizimit Nr. KU0H150107115913 për periudhen Dhjetor 2014- Shtator 2018".*

Në datën 08.01.2019 në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros në kuotat e palës debitore Ujesjellesi Has sha me NIPT J66702907H.

Me kërkesën Nr.1402/9 Prot datë 18.01.2019 të kreditorit Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a është vendosur pezullimi i ekzekutimit deri në një kërkesë të dytë të kreditorit.
Me kërkesën Nr.1902/7 Prot, datë 22.02.2021 është kërkuar rivënia në ekzekutim dhe vijimi i procedurës në veprimin proceduriual në momentin e pezullimit.

**Per kete arsye:**
Si dhe në bazë të neneve 519 të K.Pr.Civile,

URDHEROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë verifikimin dhe bllokimin e kuotave të debitorit Pompa Ujësjellësit Has, Ujesjellesi Has me NIPT J66702907H, si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe ose disponimin e tyre dhe moskryerjen e asnjë lloj veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar .
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 5 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
BESNIK DOKUSHI

**Përmbaruesi Gjyqësor BESNIK DOKUSHI** Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 3 Tirane, Cel: +355 68 90 32 533, NIPT L62114047R, NR. LICENSE LN -2119-09-2016